

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“BEZATI COMPANY” SH.P.K.**

Sot, më datë 15/07/2023

**Z. Alend BEZATI**, i datëlindjes 05.06.1983, lindur ne Lushnje dhe banues ne Durres, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti me **Nr.I30605083T**

Ka përpiluar këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare **“BEZATI COMPANY” SH.P.K.**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare **“BEZATI COMPANY” SH.P.K.**, themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **“BEZATI COMPANY” SH.P.K.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë është:

- Prodhim, tregtim montim qepenash llamarine, punime metalike, punime duralumini, si dhe aksesoret e tyre, etj.
- Tregtim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme industriale.
- Transport te udhetareve e mallrash brenda dhe jashte vendit per vete, per te trete e me qira..

- Agjensi Imobiliare, shitblerje pasuri te luajteshme dhe te paluajteshme, dhenie dhe marrje me qira, asete, pasuri te paluajteshme etj.
- Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme.
- Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

Shoqëria ka seline ligjore:

**Durres, Xhafzotaj, Fllake, Rruga VLLAZERIMI, Zona Kadastrale 3852, Godine me Nr.pasurie 344/67, Kati I-re.**

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke dhe përbëhet nga 1 (nje) kuote.

**2) Z.Alend BEZATI** është zoterues i **1 kuote me 100%** pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 100.000 leke.

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet **për një afat 5 vjeçar**, me të drejtë

riemerimi. Administratori i Shoqërisë do të jetë **Z. Alend BEZATI** pajisur me Karte identiteti me Nr. H11003004L.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 9**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 10**

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduajnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 11**

##### **Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqërisë . Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

#### **ORTAKU THEMELUES**

**Alend BEZATI**

*Alend Bezati*  
